

INTERVISTË ME ISMAIL GASHI SLOVIAN

Lipjan | 20 shtator, 2016

Kohëzgjatja: 65 minuta

Të pranishëm:

- Ismail Gashi Slovia (I intervistuari)
- Erëmirë Krasniqi (Intervistuesja)
- Noar Sahiti (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Ismail Gashi: Unë jam Ismail Gashi, i lindur me 14 qershor, 1945, në fshatin Sllovi të Lipjanit.

Erëmirë Krasniqi: A mundeni me na tregu për kujtimet ma t'hershme të fëminisë, rrethin, familjen, ku jeni rritë, ku keni shku n'shkollë?

Ismail Gashi: Po, është fëmjëiri e pas luftës, ardhjes të komunizmit dhe fëmijëri e varfër. Në përgjithësi populli shqiptar ishte i varfër që nuk shpëtoi nga varfëria, por veç iu randu edhe ma shumë, ajo varfëri me forma t'ndryshme komuniste, sidomos popullit shqiptar. Unë shko... unë shkollën fillore e kom krye në vendlindje, katër-klasëshen, pesë... t'pestën deri tetën n'fshatin Gadime, sepse ishte asaj kohe e vetmja shkollë tetëvjeçare n'gjuhën shqipe. Në pjesën, t'thom, lindore të Sitnicës të ksaj komune, nuk kishte tetëvjeçare tjetër. Pas tetëvjeçarës kom vazhdu msimet me vëshirësi të ni fëmije fshati. E kom regjistru gjimanzin në Prishtinë, atëhere kemi bajtë edhe bukën me veti për ni javë. Kem banu nëpër dhoma jo...ma t'lirat edhe jo t'mira domethanë. Aty kom mbaru...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishte jeta n'fshat? A mundesh me na përshkru?

Ismail Gashi: Jeta...

Erëmirë Krasniqi: Mos po ngutemi me shku deri n'shkollë t'mesme, a mundesh me na tregu për jetën n'fshat n'atë kohë?

Ismail Gashi: Jeta, jeta n'fshat...

Erëmirë Krasniqi: Qysh ishte?

Ismail Gashi: Ka qenë jetë fshatare, ka qenë jetë që s'kshim domethanë standardet që janë sot. Nuk kanë qenë ato standarde, as elektriku, domethanë ka mungu gjithsesi, se ka ardhë tepër vonë ka qenë gjendja ekonomike bukur nën presion shtetit. Unë s'i kujtoj krejt, por flitet për tepricat që jonë marrë gjithshka, me drith, e me bylmet, e me bagti, e me mish. E shiptarëve zakonisht iu është qitë teprica ma shumë se çka ka prodhu ara, ta zomë, gruri. Dhe domethanë, shqiptarët kanë qenë pak t'shtypun si t'veçantë n'ato kolektivat e tipit Stalinian deri '48, ma vonë jonë prishë kolektivat, por varfëria ka qenë e nivelit. Po du me thanë për gjithë, gjithë populli ishte e një shkalle t'varfnisë, si me thonë, se ata mirreshin kryesisht me bujqësi. Kosova nuk kish ndonjë industri që t'inkuadronin n'punë, shkollimi ish... shumica e fshatrave kishin vetëm shkollimin katër...fil...katër klasë fillore. Çka e arsyetonte

politikën e Titos jashtë, se edhe shqiptarët kanë në gjuhën shqipe shkollë, po kur atë hallkun e shkëputjes, tetëvjeçaren nuk e kishte n'shemicën e fshatrave, por n'fort të rralla. Ajo ishte shkëputje që ne nuk mund, nuk mund t'shkonim në shkollë t'mesme pa e mbaru tetëvjeçarën. Une e kom mbaru edhe kom shku tash n'gjimnaz, po aty kom kry dy klasë, gjimnazi për çashtje bursi, për çashtje ekonomike jom detyru me u transferu në Normale, a kom mbaru Normalen në Ferizaj.

Erëmirë Krasniëi: E për familjen, a kishe mujtë me na tregu diçka për familjën tonde?

Ismail Gashi: Une me t'thanë t'drejtën aty s'dashta me hy fare, se unë jom rritë jetim. Nana m'ka vdekë diku n'moshën dy-tri vjeçare s'e kujtoj, ja jom pak (qeshë) ma i rrallë po thom, jo nuk m'kujtohet, pak episode, pamje m'kujtohen për nanën, jom rritë pa nanë do t'thotë...

Erëmirë Krasniqi: Kush është kujdesë për ju?

Ismail Gashi: Ah?

Erëmirë Krasniqi: Kush është kujdesë për ju?

Ismail Gashi: U kujdesë gjyshja, nana e babës, ma vonë ni gru e mixhës që ishte tezja ime, që e kom çmua më vonë si nanën time atë teze.

Erëmirë Krasniqi: A keni jetu me ni... bashkallak?

Ismail Gashi: Kena jetu me ni bashki familjare me dy axhallarët, kemi qenë deri dikund 23-24 anëtarë në familje. Fëmija atëhere kanë, nuk kanë guxu t'shkojmë n'odë burrat ku rrinin, por kemi nejtë n'shpijën e zjarrit me gra. Nëse do t'ishte, mu m'duket ashtu, n'atë kohë pak fmise u jonë shkelë t'drejtat, jo me qëllim... Po na edhe kur kanë bo naj gjellë t'mirë e naj copë mish fëmive ma rrallë ju ka ra, se niherë oda e merrte mishin e mirë atë sofrën e parë, tani gratë pak ma dobët sofrën e dytë, e fmija çka metke prej dyjave (qeshë). Nuk e kena pasë fmininë e shëndetshme boll, përveç kena hangër ushqime natyrshme, po edhe...

Kshtu që te shkollimi po thom ish... kom mbaru Normalën, jom kthye n'vendlindje. Atëhere kemi qenë shpi n'veti me vllaznit, se i kom dy vllazën, atje kemi qenë shpi n'veti. Unë kom punu msus aty në Sllovi, në fshat të lindjës nja ni vjet. Në '66-'67 vitin akademik jom regjistru n'gjuhë letërsi shqipe në Prishtinë pas...

Erëmirë Krasniqi: N'çfarë rasti ju përcjellshin gjatë kohës së shkollës mesme?

Ismail Gashi: Rasti ishe... n'shollë t'mesme ka pasë edhe përcjellje, se mu m'kujtohen ma vonë në Ferizaj pak ma i madh, se n'gjimanz në Prishtinë nuk e kom ditë. Kom qenë i vogël me i kuptu ato ndikimet politike, por në Ferizaj po, se vinin njerëzit gjoja t'na jepnin neve do ligjërata pedagogjike, psikologjike, do persona serb, vinin prej Beogradi. Ata me shumicën e rasteve nuk spjegonin asi tema që deklaroheshin se janë pedagogë ose psikologë, por spjegonin tema politike. Flitnin zakonisht terr e zi për Shqipërinë. Se osht' me Kinën, se kinezët vijnë me avion me hongër drekë në Tiranë edhe kshtu

qysh, kem pasë hasë niherë ni problem, se s'ka llogari me ardhe kinezët me airoplan (qeshë) në Tiranë se harxhojnë ma shumë se drekat që i hanë aty. Edhe ata zakonisht ato pyetje i marrshin si që p'i boj me qëllim.

M'nalshin ma vonë masi u kryjke ligjërata me m'pytë "Kush je, e tek je? Pse e bone këtë pyetje? A t'ka thonë dikush me bo këtë pyetje?" U sqarojshim që ai ish instikt faktikisht, se nuk ishim na që na ka shti kush me bo pyetje atyne profesorëve të qujtur n'thojza {bën me duar} ... se ata profesorë nuk ishin si duket, ishin krejt punëtorë t'sigurimeve të shtetit që donin me ditë kush janë kta mësus që nesër dalin nëpër... nëpër klasa n'xanësive shqiptarë çka, çka mujnë me msu kta, donin me na njoftë para se me hi n'klasë. Por në Normale nuk kemi pasë probleme tjera t'mëdha.

Ajo pjesa e Normalës që ka qenë e ka, e ka vuejt, e ka përjetue drejtoria ose profesorët, sidomos drejtori me pushtetin. Me neve drejtëpërdrejtë nuk kemi pasë shumë problem, pos ni herë ni Abdyl Rama, jom konë shok i pandashëm me Abdyl Ramën, kemi lypë, dalshëm me marrë gazetën "Rilindja" te treni ardhke para tetëve. Edhe na tu pritë, aty ni polic serb Abdyl e kish, e kish pasë njoftë që osht' Urosh i qujtun, se paska pasë punu në Suharekë n'katun... te vendlindja e Abdyl Ramës, u konë i Reqanit të Suharekës. Edhe ai po na pytë "Pse, çka po pritni?" "Me marrë Rilindjën". "Po hajt se kanë ardhë gazetat tjera merrni." "Por jo, po na 'Rilindjën' p'e... p'e presim". Ish para plenumit, para Rankoviçit kjo, "Phaj, na për Rilindje, serbisht nuk kem çka me lexu serbisht" s'do... se kishim marrë kurrë realisht edhe atij i tham, "Hajdi pra masi s'po doni me marre, hajdi..." (qeshë) na pat çu n'stacion të policisë na dha ka nja katër-pesë shapulla edhe shkoni n'klasë.

Po naj rast t'veçantë tjetër jo, por edhe ai rasti kur u burgosë Adem Demaçi po, '64 na ishim maturantë. Ni shok i... p'i atjehit erdh ni Gani Shala që ish kanë në Mitrovicë. Zeqir Gërvalla u burgos, i shoqi i klasës tij edhe na spjegoj ai që Adem Demaçin e kanë burgos përsëri. Na kishim ni për bacin Adem, kishim ni po nuk e dishim qartë, se rrallë kush dinte edhe ai që dinte nuk fliste. Tani e msum pak aty p'i atij shokut Gani, se osht' burgos, se ka hedhë flamuj, se ka ba kte e kte edhe si me thanë na lindi pak n'atë vjet e funit të Normalës, na lindi mornicat e çashtjës t'kombit, pak mosha...

Erëmirë Krasniqi: Domethanë krejt kto ia nisën me ndiku...

Ismail Gashi: Kto kanë ndiku normalisht se gjithë jetën...

Erëmirë Krasniqi: ...Transformimi politik...

Ismail Gashi: ...tani... tani gjithë jetën na kanë ngacmu ato, ato mornica p'i quj une kshtu që t'xiglojnë pak, edhe me studime masnej kemi ardhë deri te '68, pamvarësisht qe u premtunë shumë ato mrekulli mas ramjës të Rankoviçit. Për hesap tem, kom bisedu atëhere edhe me shokë edhe n'burg edhe kshtu n'jetë private nuk ka pa [pasë] ndryshu kurgjo sistemi kumeditë çka. Shiko, sigurimi i shtetit kanë qenë ata baballarët t'verifikum, njerëz që i kanë çu djemt aty me punu, mos m'i përmen me emna se s'ka kuptim. Ose ka qenë ai, ai spiuni, bashkëpunatori i UDB-së të Rankoviçit, tash osht' bo vet UDB-ash, jonë konë mes tyne ata shqiptarë qe kanë bashkëpunu, me emna me marrë s'po përmeni përsëri se himë n'ata sun i thojmë krejt edhe...Nuk ka ndryshu kumeditë çka, se ajo gjendja

trumbetimi se tash e kem kushtetutën veç emnin se ka republikë, se gati republikë osht' e dëshmoj edhe grupi i Kamenicës ai kur u burgosën [në] '75, 35 veprimtarë të çashtjës kombtare. Nuk u dënun fort lehtë, dhe baci Adem i morri përsëri 15 vite nuk u, nuk pshtun lehtë. Ata djem që pushteti domethonë, rrinte mbi kokë, kush po tenton me lëvizë atë çashtje? Se mashtirimi i shtetit nuk i shkoj gjatë ata e bani '68, po menoj '81, u përsërit vazhdimi i '68 ato kërkesat e '68 që i plotësun gjaja qeveritarët tonë. Bile thojnë, "Na i kena plotësu ato," qever... kta politikanët shiptarë, por universiteti, kushtetuta, barazia e gjuhës, flamuri jonë dhonë në kërkesa t'studentëve, nuk jonë dhonë merita e udhëheqësave.

Erëmirë Krasniqi: Në '68?

Ismail Gashi: Në '68 studentët i nxorrën edhe unë p'e ni [ndegjoj] edhe në intervista... jo Azem Vllasi jo do tjerë e, na i kena dhonë kto, e kena pru kushtetutën, nuk e kanë bo ata, se mu m'kujtohet niher n'fakultet Ismail Bajra pat' ardhë, edhe na e kishim, ndodhën ngjarjet n'Beograd para tonave edhe na i, i shtrumë n'hymje t'filozofikut ni pyetje, "Qysh po ta merr menja ty me hy n'ndërtesë t'qeverisë t'Kosovës aty flamuri serb e jugosllav edhe i partisë që u konë atëhere nuk e ki flamurin kombëtar", tha "S'e kom as une lehtë", Po atë'here pse se keni çelë as ni herë këtë muhabet?. Kta pi '48 kur u nalë dej '68, 20 vjet nuk e ka lypë as ni udhëheqës i joni su dalë kurrë për, hapur, dikun me ni forum ose me ni mjet informimi ose me ni nivel shteti me thanë kti popullit nuk ban me ju ndalu edhe tutje flamurin kombëtar. Po ato kur na e kërkom '68 për me na i shtu atë republikën kta i dhanë kto formalitete, mirret vesh që i dhanë po edhe i majtën n'durë t'veta përsëri se i majtën me njerëz t'vet.

Erëmirë Krasniqi: A ju përcjellshin juve mas '68?

Ismail Gashi: Mas '68, normalisht që kta kanë përcjellur, sigurimi ka përcjellë krejt, se pa shku n'sigurim nuk e dijmë kush po përcjelllet (qeshë). Në sigurim, ata kur t'shkojsh e merr vesh që ata kanë përcjellë çdokënd, bile edhe ata njerëz që ja u ka marrë menja atyne edhe popllit që jonë me ta. Kur ata t'pysin edhe për ni person udhëheqës komunal, atëherë te une për shembull pytshin për ni Fehmi Jupqi, ish në pushtet ai, ish-udhëheqës komunal, po ish ma i dallum se tjerët, mirret vesh se pytshin për njerëz tjerë që ishin n'nivel partiak t'ngritur, ishin si me thonë t'çerifikum masën... masën e vet po kanë hetu edhe njerëz mrena popullit po thom, n'mjediset tona nuk na ka shku menja as mu, e as shokëve t'mij që sigurimi i shtetit t'përcjellë edhe atë. Neve, neve dihet na, edhe kur jemi dalë, edhe kur jemi dalë p'i burgut ke qenë me vendim...

Erëmirë Krasniqi: A ju burgosën në '68?

Ismail Gashi: Në '68 jo, por kur jom shku ushtar atje m'erdh p'i ktuhit vendimi që më kanë bo, gjoja kom bo zhurëm une me ni shkollë ktu t'fshatit edhe m'kanë kthy atje n'ushtri. Atje m'kanë çu n'gjykatë ushtarake të Zagrebit se kom shërby në Rijek. U konë atëhere si i thojshin ajo zona e pestë ushtarake, Zagrebi ish qendra e tyne, atje m'kanë denu, 60 ditë po nuk, nuk m'kanë dënu shumë çka kanë shkru ktu...

Erëmirë Krasniqi: A ish shpifje ajo që ju keni propagandu në ambiente shkollore, a qysh?

Ismail Gashi: Ajo ish, ajo ish... aty n'gjyq kur ma caktun edhe ni mbrojtës, ni major malazez. I kishin shkru ktu n'komunë katër faqe, gati katra e gjysë diçka rreshta ma shumë, realisht veç dy rreshta ishin që lidhej me ato se gjoja une n'shkollë kur kom hi me uniformë i kom sulmu qeveritarët lokal, une as s'kom hi n'shkollë kurrë me uniformë ushtarake (qeshë)...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë uniforme?

Ismail Gashi: Une kom ardhë për ni provim atëhere me dhanë, për me bo ni vjeçar ushtrinë, s'kom ardhë me uniformë n'shkollë as n'provim s'kom shku me uniformë ushtarake, se s'e kishim na qaq për qefi atë uniformë. Po atje mas 45 dite, nja 15, drejtori i burgut në Opatija të Sllovenisë atje, ka Sllovenia...

Erëmirë Krasniqi: Kroacisë...

Ismail Gashi: Opatija osht' ven i njoftun po, atje dikun te Luga Mali [Mali Lug] ka qenë burgu ushtarak. M'i ka shlye nja 15 ditë, 45 i kom majtë. Kom ardhë ktu nuk m'kanë dhanë punë, kur jom kthy ktu. Në teritor t'komunës s'më kanë leju me punu, jo me t'shkru vendim që s'ki t'drejtë, por nuk kanë leju. Ku ke konkuru me punu jom sjellë nja tre mujë ditë n'marrëveshje me atë drejtorin e, atëherë e qujshin drejtorin e arsimit, BVI-ja [Bashkësia Vetëqeverisëse e Interesit] e arsimit. Ai dikur edhe përkundër dëshirës m'tha, "Bon, bon diqysh, largohu." Eh, jom shku n'Gilan unë, me 1 mars, '70, jom pranë n'gjimnaz. Pa diplomu isha, por kom dhonë msim aty deri... aty kom diplomu gjatë punës n'gjimnaz të Gilanit, po kom punu dej në '74.

Në vitin shkollor '74- '75, me 1 shtator kom ardhë ktu në Lipjan me ni gjurullti t'vogël, por pa gjurullti jo. Se ata që ishin udhëheqës tash, ishin do ish-arsimtarë t'mi që me t'thanë drejtë ham kishin pak nifar simpatie si nxanës kam qenë gjoja i mirë, simas, si thonë ata edhe atëherë thoshnin. Por, edhe pak ajo rebelimi jem ju pat pëlqy arsimitarëve, se kishim rini ma pak që rebeloheshin. Prandaj, une nuk kom pasë edhe atëherë edhe p'i atëherit e me vonë s'kom pasë shokë t'moshës sime ktu, se t'moshës time s'kanë qenë me mu atëherë. Po kom punu ktu dej '79, '79 me 23 qer... nondor, jom arrestue për shkak t'atyne lëvizjeve. Titoja që ishte n'tetor na i bam do veprime tona paknaqësie për vizitën e tij n'bazë t'asaj lëvizjes nacional-shlirimtare për shkrimin e viseve shqipëtare të Jugosllavisë dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë edhe kena... atëherë jon burgos me dheta, une bile qysh kom info... fjalë, s'kom shënime t'sakta, flitej dej në 400. 26 jonë marrë në Lipjan, 26 veta, ish-nxanës, pak edhe nxansat aktual t'atëhershëm, mësimdhënës edhe rini tjetër, intelektuale p'i quj ata që studionin e që ishin studentë t'mirë. Mas burgut...

Erëmirë Krasniqi: Sa ju majtën? Sa ju majtën n'burg?

Ismail Gashi: Pesë mujë kom nejtë une hetimet, masi u shpallëm për ak... për tre mujë masi u shpallëm për penale, na klasifikun për penale. Na lirun me motivacion se Kryesia e Kosovës osht' ma e mirë se ju (qeshë) edhe ajo po ua falë shumicës. Na jemi lirue me 24 prill '80, një pjesë, unë edhe Ibish Qerleci që ishim me ni vendim. Me ni vendim edhe tjerët jonë lirue viseve t'ndyshme, se jonë dënue, jo

veç të Lipjanit, [por] krejt Kosovës, Lëvizja s'ka qenë as veç e Kamenicës, as veç e Lipjanit, por ka qenë n'krejt Kosovën e shtrime, edhe s'kom punu...

Erëmirë Krasniqi: Çka bonët mas burgut? Po meno, kur jeni liru?

Ismail Gashi: Une kom nejt n'shpi, kom pasë kushtet e rana. Shoqën ma hiqën prej punës se shoqja ka pasë rusishtën, ka punu aty me mu n'shkollë t'mesme. E hoqën në shtator, se je e shoqja, bashkëshortja e ktij. Nejtëm dy vjet as njeni pa punë, e shoqja u gjet besa, e boni ni rrobaqepësi me do letra, me do modele, qepte me maqinë me nxjerrë bukë për, për fmitë, se i kishim na dy vajza, t'tretën e gjetëm qatëhere, ma vonë edhe ni djalë e kom Shumbinin, por vajza e madhe ka kry magjistraturën e letërsisë, jeton, u martu edhe jeton në Ferizaj edhe punon. Vlora, e dyta osht' në Gjermani, atje jeton edhe punon. Arjeta, osht' ktu me punë, por u martu në Tiranë, është në Ministri të Administratës. E djalin e kom inxhinier të kompjuteristikës, Shkumbini punon në Ministri të Arsimit e manë rrjetin e kompjuterëve, se kalum në privatësi.

Nuk kom punu dej '85, '85 kom hi në kooperativë zejtare i thojmë, atëhere u formunë do kooperativa që grumbullonin punëmarrës me marrë me ndërto naj ndërtesë t'vogël, me ngjitë rrymën, me ly e me maru kanale. Ata zejtarët i kishin do grupe punëtorësh, na i bonin bashkimin e tyne me një kooperativ zejtare. Unë punoja administrator aty, maja letra administrate, deri '95 kom punu. A të '90-tën me forminin e proceseve demokratike te na, unë kam qenë iii angazhum që n'ditën e parë... n'zgjedhjet e para domethanë, me fillim të Lidhjes Demokratike, kom qenë anëtar kryesie vazhdimisht deri '99 kom udhëheqë informimin n'atë komisionin e degës. Në dy palë zgjedhje presidenciale edhe kuvendit të Kosovës t'atëhershme '92 edhe '98 jom zgjedhë deputet, kam qenë deputet pa pare atëherë (qeshë) edhe p'i '95 e kom udhëheqë tash arsimin.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ka qenë aktivizmi juj gjatë viteve '80, a na tregon qet' fazë?

Ismail Gashi: Në '80, demonstratat e '81, realisht nuk jonë shkëputë, veprimet patriotike nuk jonë shkëputë. Edhe '89, edhe formimi i partive, Lidhjes Demokratike, pak ditë ma parë edhe Këshilli i Drejtave të Njeriut, se kom punu edhe aty goxha shumë, edhe partive tjera mas Lidhjes Demokratike ishin vazhdimësi e demonstratave të '81. Se u çelë një rrugë që... formimi i partive për mue ka qenë ni, ni e mirë e madhe, se nuk ishim më ilegal, punonim publikisht e u shkoqëm prej ilegalitetit, dulum publikisht punum n'Lidhjen Demokratike. Siç e dini edhe ju, ajo fazë ka qenë e dhunës tepër t'ashpërt të Millosevçit, se u mbyllën edhe... na u murrën venet e punës, na u mbyllën objektet shkollore, u banë proc... trysni t'mëdha edhe materiale, populli ish n'varfni, e toni ma shumë me diasporën edhe me halle t'bujqsisë, prodhime tona.

Une e di që arsimin e kemi majtë me 70 përqind me mjeteve prej jashtë, domethanë Këshilli Qendror i Financimit që grumbullonte mjetet që vinin nga jashtë, e vetëm 30 përqind kena mrrij mi ba ato copa rroga t'vogla t'msusve që prej vendorve, prej popullatës, se ishim t'varfën s'kishe kujt t'i merr ai, s'ish n'punë. Kto që u formun, Pajtimet në '90, sistemi arsimor edhe UÇK-ja janë fenomene të dekadës t'kalume që e kanë sjellë këtë shkallë, shkallë ka ardhë deri te pavarësia.

Erëmirë Krasniqi: Qysh u përfshitë ju në Pajtime?

Ismail Gashi: Në Pajtime, u përfshimë, domosdo u përfshimë, ish, ish moment që t'fante puna, të kërkonte puna, ne nuk kemi qenë të imponum, po bile porosia e profesor Antonit ishte që merrni njerëz që i pranon rrethi. A osht' student, a studente, a osht' punëtor, mësus, a osht' hoxhë, a osht' prift, [vec] nëse e pranon rrethi. Ne mendum që rrethi ku ishim pak ma t'theksum deri ato momente, rrethi na pranoi mirë, kur i fillun pajtimet na pranun mirë. Tash momentin me 2 shkurt [1990] para se me fillu pajtimet, na e kena ba një pajtim ato ditë, me 2 shkurt e bamë pajtimin te vorri i Xhevdet Breznicës që u vra me 1 një shkurt, në të '90, në demonstratat e Magurës. Për me zmadhu atë vorrim, ato varrime baheshin masive, kishim afër 10.000 vetë n'vorrim edhe e bamë atë vorrim ma madhështorë që dy familjet paj.. që arritëm pajtimin ditë më parë ta bojnë shtrimin e dorës t'pajtimin te varri i Xhevdet Breznicës. Edhe ai u pranua edhe prej masës pjesëmarrëse n'varrim, u pranua shumë mirë.

Edhe ne na u duk se kjo punë po dhezë kur u nisën edhe pajtimet kshtu zyrtare, jo u nisën në Pejë, rinia studentore i nisi ajo ma si aksion. Jo idetë e ish, ish të burgosunve që ishin tani në liri edhe njerëzve të mençur edhe të traditave kombëtare. Se na pajtime të gjaqeve kemi pasur edhe ma herët, edhe Haxhi Zeka ka organizu pajtime edhe ka pasë pajtime nëpër vise lokale, t'lokaliteteve ma të ngushta, por edhe ma të gjëra. Ky ish një aksion i pajtimit ma masiv, i përfshiu gjithë Kosovën edhe gjitha niveleve edhe gjitha llojeve t'pajtimeve. Bile unë thom me... pa ngurrim se na e bamë edhe një farë pajtimi politik, një pajtim politik e bamë se nuk zunëm hasmi t'ma... se kush m'ka shpijunu kush ish kryetar m'ka çu n'burg, kur u pajtu Fadil Hoxha edhe Hysen Tërpeza u murrën n'gryk me një, me një takim në Prishtinë, ai ish kunorizimi i pajtimit politik. Nuk ish...

Erëmirë Krasniqi: Çfarë raste kishit knej ka Lipjani?

Ismail Gashi: Raste ktu i kena pasë si çdo rast tjetër, t'gjitha llojeve. Kemi pasë ngatrra për mexha, kemi pasë ngatrra për... për gjithçka, për bagëti, e për fymje, për shamje, për mospajtime bashkëshortësh, kemi pasë vrasje t'shumëfishtë mrenda familjës, e ngatrra t'rana. Domethanë që shkonim me atë porosinë e profesor Antonit që, "Ku asht' mas randi, nisjani ma herët", që duhët me shku disa herë. Na ka ndimu shumë rinia femnore, studentore, unë po t'thom një Drita, Drita Konjufca, një Vahide, Vahide Retkoceri që janë dallu, një, osht' avokate tash... Gashi. Kjo, osht' avokate n'Prishtinë, ajo e njoftun, avokate osht', ka punue n'polici, Hilmije m'dokët, nejse kta, kta p'e la si kontestuese e, e gjeni ju në Prishtinë edhe ma lehtë se mu nashta ma vonë m'kujtohët. Kanë ndihmue edhe rini studentore edhe rinitë ms... arsimore, mësust, arsimtart, hoxht...

Erëmirë Krasniqi: Qysh u informojshit për raste?

Ismail Gashi: Na për raste jena informu prej njerëzve t'mjediseve t'ndryshme që jonë... unë kom pasë qat' kooperativën, aty e kemi pasë qendrën na pajtimtart. Jonë ardhë përditë aty se edhe Lidhja Demokratike, proceset politike, unë i kom përcjellë lajmet me një faks. Kom pasë aty faks, e i kom përcjellë e u kanë si qendër informative e vogël ajo, i kom përcjellë edhe aty kanë ardhë njerzt, e i kanë pru. Te na p'e zamë asht' një rast që jonë rrehë moti, nuk flasin qe sa vjet e qeshtu i marrshim

informacionet, u caktojshin njësitë, grupet kush me shku, aty te, te kooperativa jeme u kanë nifarë barake e vogël, nja tri dhoma t'zyres, si zyre aty u tubojshim, aty u niseshim por nuk ka pasë pak veprime pajtimtarësh mrenda lokaliteteve ma të vogla.

Unë e di që në Drenicë kena shku dy tri herë, po ata drenicakt Shala, Krojmiri, Petreshtica asht' nji tërsi e vogël aty me qendër në Shalë. Ata e kanë kry vet, arsimitartë e studentë e tyne kanë kry pajtimet, bile nja dy-tri herë na kan ftu veç kishe na pak, pak ma të vjetër. Sikur e thirrshim na kaniherë Anton Çettën kta, që kur bojshim tubime na kena pasë tubim në Bujan kem pasë tubim në Veshevc, kemi pasë tubim pajtimi n'Smallushë, kemi pasë tubim pajtimi edhe në Bujan thash po, në Gadime, po.

Erëmirë Krasniqi: Çka ju thojshit njerëzve, çka ishin ato argumentet kryesore?

Ismail Gashi: Po në tubime, në tubime normalisht na njerëzve edhe kur e kemi kërku pajtimin nuk e kemi kërku se ai, ai, ai na ka çu, por, po kërkojmë pajtimin në emër të ktij populli, të ktij veni ksaj shtate t'ranë nuk mujm me shku na ma tutje. Nëse nesër dalin, ta zamë nji front, a nji konflikt me kta armiqt na nëse ruhmi njeni tjetrit, i kom hak ktij mrapa kemi pasë kto muhabete. Jonë citu fjalt e bacit Adem shumë e jo do, ai, “Nuk osht' trim ai që ngrehë gishtin e krrimit, por ai që e shtrinë dorën e pajtimit”, jo, qëso. Kaniherë fushatë u kanë (qeshë) se kto, kto pajtimet me nifar forme kanë qenë edhe nifar fushate, ka mundsi që t'ketë pasë edhe defekte aty, ka mundsi...

Pjesa e Dytë

Ismail Gashi: Po i ndëgjoj plot, e i kom ni njerzt tu thanë, “Une jom kanë kryetar i pajtimeve n'këtë komunë e n'atë komunë” bile edhe për te na flitet që u kanë kryetar Avdi Kelmendi. Na nuk kena zgjedh kryetar. As Anton Çetta vet nuk, mendimi jem osht' kta mos e merrni ju për, për realitet. Nuk ka pasë kurfarë grupi i zgjedhun që kta janë udhëheqsat. Ka qenë Mark Krasniqi, ta zajmë, Kajta Recaj, Muhamet Pirraku, kanë qenë Ramiz Kelmendi, kta me, rreth Antonit, me Antonin, por ata s'kanë qenë t'zgjedhun. As Antoni vet, me gojë t'vet që e ka thanë disa here, “Une nuk jom kryetar i Pajtimit, une jom ni pajtimtar, ni veprimtar që eci.” Po e marrshin ma shumë se i ka pasë ato t'tinaj, t'natyrshme. Ka nejt n'oda, 15 vjet ka punu n'Drenicë n'folklor me mledh kangë popullore, i ka msu krejt mentalitetin e odës. Po, po megjithatë kur e bojshim kanihere muhabet pak ma t'libër thojke, “S'e kisha pa ditë çka osht populli. Une qitash e msova popullin, sa s'e kom msu 70 vjet përpara. Se sa e sa t'zeza i paska pasë, t'u hjek n'asi shëmti, që e kanë munu mrena përmrena si osht konflikti i hakmarrjes”.

Erëmirë Krasniqi: A ish vshtirë me hi nëpër oda edhe me sygjjeru me pajtu njerz?

Ismail Gashi: Jo dikur, dikur, dikur, dikur me të thanë t'drejt për neve që ishim meshkuj dhe pak ma t'moshum ma lehtë. Por, une gjithëherë kur jena shku grupe kena pasë shumë vajza, edhe për vajzat n'fillim mu doke mos po nihen si t'ngurrume u dashke m'i privilegju pak ma shumë, m'i qitë krye venit. E ma t'privilegjume ishin, se e kanë meritë ato që i përmena. Na kanë ardhë n'ndihmë, ajo Nekibe

Kelmendi, Sanije Gashi u kanë në atë “Kosovare” kryeredaktore atëherë. Na ka angazhu ajo gjininë femrore ktu shumë.

Erëmirë Krasniqi: E me jau ndrru menen? Me ndrru qat’ mentalitet? Se pajtimet pak e kanë ndrru mentalitetin mrena n’oda. Sa ka qenë qajo e vshtirë maspari, mandej edhe m’i bindë?

Ismail Gashi: Ka ndrru, ka ndrru se rastet janë. Raste t’veçanta ka që nuk kanë mujt me ndryshu. Kur kanë qenë ngatërresat e ashpra, ma t’afërta me farefisn, ma mrena farefisit. Ose kur jonë vra burrat po zamë, jonë metë gra, osht’ dashtë m’i marrë gratë. Se atë fjalën e pajtimit u dashtë ta japin gratë që ju kanë vra burrat, po atë bindjen se mospajtimi, belaja, t’varfnon ekonomikisht, t’varfnon edhe shpirtnisht, se e varfnon edhe popullin, se nëse ai sun del me mjell arën, me mjell patate, me mjell misër, fasule, ai tregu nuk ka me pasë, ka ma pak, ma pak edhe kshtu që varfnohet edhe populli. E ana tjetër shpirtnore, ki gjithë me majt n’kokë ja ma ka ai borxh gjak, gjakun borxh, qysh ka me vra? Kur ka me vra? Kur ta vras, kom me shku n’burg, shka bahet me fmitë, çka bahet me gruen, me vajzën, me djalin? Ajo asht’ ni ngarkesë që e ka rënue popullin me t’vërtetë, deri, thuja deri n’padurim. Në padurim. Kshtu që, pajtimet kanë qenë t’dobishme. Antoni zakonisht, profesor Antoni e ka përdorë atë, “M’u pajtu, u pajtut, por e keni vshtirë, rune! Me prishë nuk bon! A me nreq, e nreq, po me prishë nuk bon!”

Erëmirë Krasniqi: Çfarë raste keni pajtu ju? A keni qenë ma shumë pajtimtar, a ndërmjetësus?

Ismail Gashi: Jo, pajtimtar kemi qenë, me grupe me shokë, me t’ri, me t’reja, me...

Erëmirë Krasniqi: A mundesh me na fol për naj rast?

Ismail Gashi: Po, kem pasë, për shembull në Smallushë që janë vra dy-tre vetë nërveti, në konflikt për tokat. Ata kanë lanë gra e fmi. Kena shku jo niherë, kena shku disa herë, disa herë. Kena marrë edhe thashë edhe Sanijen edhe këtë, Nekiben me bisedu me gratë atje. Me jau mush menen, se ai, se ai kunati si me thanë mashkulli që ish metë, ju kanë vra dy vllazën edhe ai që ish metë burrë aty nuk e kish lehtë me thanë p’i fali, se e kish hallin çka thojnë kunatat, ato që ju kanë vra burrat, ose fmija tyne.

Osht’ ai problem mrena familjes, na duhet me kuptu gjithsesi se jemi nivele tjera tashti që mujmë me kuptu ato. Edhe normalisht që ka pasë nevojë me qenë edhe Nekibja, me qenë edhe ni Nekibe tjetër ose ni studente, ni mësuse, ni arsimtare, ni gazetare, me folë me ato se, “Ju nuk jetoni mirë nëse nuk e falni. Ma lehtë jetoni me falë, e ai nuk ringjallet. Me falë i shliron fmitë, shkarkohesh shpirtnisht, je ma i lirë edhe ti edhe fmija, edhe çilet jeta, çilet ambienti”. Bile, që thojnë populli, çilet edhe havaja.

Erëmirë Krasniqi: Naj rast tjetër?

Ismail Gashi: Kem pasë raste që e ka vra n’Krajmir, për shemull e ka vra djaln e vllait. Jashtë jonë vra edhe tashi duhej m’i thanë atina, “Falja vllaut që ta ka vra djaln.” Edhe ai e mrriti ata me falë, po kur i thamë, “Hajde ti me neve tash te vllai,” u kanë Mulla Idrizi Kokrruku na ka nimu shumë, a din se ai ka qenë ma shpesh ktu te ne edhe, për Antoni po, po edhe ai ka qenë ma shpesh se Antoni, tha “Nuk kom qysh me ardhë” tha. Tash e kish edhe baben, kta e kishin. Baba plak 85 vjeç. “Hajde çu axho,” p’i

thojmë, “edhe ti hajde te ai djali tjetër shkojme ja çojmë faljen.” “Po qysh me ardhë, more?” Tha. “Se na jena koritë edhe jena fikë, se na ka fikë avokatia, tu e mbrojtë edhe ata, tu e mbrojtë edhe kta.” Tu i lypë atij edhe ktij pare. Tu shitë kta gjithë pasuninë edhe djalin edhe t’vramë në hasmi nërveti e ka vra djalin e vllait edhe jena varfnu kshtu. Ka pasë raste t’ndryshme. Secila meriton mu përmend ta zamë. Bile, bile, edhe kto për ni urë, “Pse p’i maron ktu? Pse po i bjen drejt me dyrë t’mija? Se ajo drejt me dyrë t’mija mu m’pengon, jo maroje ma larg, maroje ma poshtë.” Ose për ni mexhë. Kanihere, kanihere une kom dyshu që osht edhe çashtje morale. Në kto raste nuk përmendet ajo.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë nëpër oda ju? Qysh o folë për kanunin po m’intereson? Jo për kanunin, po për gjakmarrjen si dukuri. Se plot thojnë që nuk osht e jona, na ka metë, e...

Ismail Gashi: Na kemi folë edhe shiko, se ish edhe situatë politike atëhere e dobishme me thanë qashtu, shteti i hujë se na jemi kanë n’robni t’hujën vazhdimisht edhe jemi hala. I ka ndihmu kto edhe padyshim, padyshim që nuk i ka ardhë keq as shtetit serb, as atij tjetrit ma herët, që po vriten shqiptarët, po sidomos [jo] serbëve. Këta e kem armikun ma t’afërt fizikisht, por edhe që e kem përjetu shpirtnisht ma keq. Edhe ai, ky armik ka mjell kokrra për mu ngatrrue shqiptarët. E ka mjell ata edhe e ka ndihmu pushteti, ose e ka ba njenin si bashkëpunëtor pak ma t’afërt pak ma përkrahu, i përkrahu, pak ma simpatik, a? E ka nxitë, e ka shty mu kapë me dikon se s’i ka pengu gja m’u, m’u vritë, nëse vriten shqiptarët. Asi raste i kemi përdorë kto, edhe n’pajtime i kemi përdorë se ish edhe situata.

Na ishim realisht n’front me Millosheviqin, me Serbinë, që e kishim armik historik. Armik historik edhe ai e ashpërsoi masën ndaj nesh, duhej mu përballue. N’ato tubime ma t’mdha e deri te Verrat e Llukës për shembull, që jonë kanë mbi 500 mijë vetë aty, që u tregu edhe, edhe Serbia pak e mori me trishtim atë punë se ktu diçka po ndodhë, se pati edhe tubime tjera, pos Verrave të Llukës, pati edhe tubime tjera. Na kemi pasë edhe në Gadime tubim po aq, jo sa ai, po disa, dhjeta mija vetë i kem pasë edhe u folë aty, kanë folë njerzit, kanë ba apel, “Falni gjaqet, e afronu, e merrnu vesh, e mos u hasmoni, ikni hasmisë”. Ato kanë ndiku besoj gjithë.

Bile, bile mu dok si edhe ju e përmendt se ka ndyshu pak mentaliteti. Prej atyne ka ndryshu pak. Osht’ pozitiv. Osht’ pozitiv. Une edhe sot nëpër neja në t’pame zakonisht, se edhe tash nuk mirrem me politikë se une jom n’pension, nuk mirrna me ksi aktivitete politike, po n’pame jom met si plak tash shkoj, une ata e përmeni këtë punën e që jena pajtu. Jena pajtu edhe me hasmi po edhe me politikë. Edhe politikisht jena pajtu, nuk jemi ma kundërshti. E përmena atë rastin e Fadil Hoxhës edhe Hysen Tërpezës, po.

Erëmirë Krasniqi: Pse çfarë konflikti kanë qenë ai? Çka kanë përfaqësu?

Ismail Gashi: Po, Hysen Tërpeza u kanë ballist, 50 vjet ka ikë, ka metë jashtë shtetit. Fadil Hoxha u kanë komandant partizan, që ka qenë udhëheqës i lartë domethanë. Ktu me ni tubim në Prishtinë ishin dytë t’pranishëm edhe Muhamet Pirraku e do shokë po bojnë llaf, “A i shtijmë m’u marr, m’u pajtu? M’u marrë n’gryk?” Edhe ata... ata pranun.

Erëmirë Krasniqi: Gjatë Pajtimeve?

Ismail Gashi: Jo gjatë Pajtimeve, ish ni kohë pak ma vonë, por ish ni epizod i mirë i pajtimit politik po thom. Bile ishin, se kryekomandant i Ballit ka qenë Hyseni, kryekomandant i partizanve Fadili, kur u murren n'gryk, "Po ta boj hallall, e po ta... t'gjitha, se me t'pa zatetë t'kisha vra." Ai, "Me m'pa zatetë m'kishe vra." (qeshë) U murren n'gryk e lanë atë muhabetin e hasmisë t'madhe. Për mu ka qenë ajo ni marrveshje e madhe. Nivel, nivel politik po thom, dhe kombëtar po.

Ermirë Krasniqi: Domethanë njerzve ju thojshit që gjakmarrja nuk osht e jona si traditë?

Ismail Gashi: Osht' e, osht'... osht' e trillume. Na e kena ashpërsu, se njerzt e kanë imponu nashta po. Megjithatë, tradicionalisht me marrë, historikisht na prej Perandorisë e tutje mund t'jetë e mjellun ashtu, se Kanuni e trajton. Kanuni nuk o fort i ri, osht' mesjetar, po atëherë kur nuk ka pasë kërkush Kanun, na kena pasë. Se shqiptarët dallohen që, kanë dëshmi që janë popull i vjetër, se na e kem flamurin ndër ma t'vjetrit në Evropë, por edhe Kanunin s'e ka pasë as popujt tjerë s'e kanë pasë. Pamvarsisht ashpërsisë sot që e kemi, sot nuk osht' mirë me përdorë, se i kem normat ligjore tjera, o sistemi ligjor. Ai kthimi mbrapa do t'ishte me punu, edhe pse nuk po hiqet, nuk po hiqet bash lehtë.

Erëmirë Krasniqi: Te Verrat e Llukës, a po na kallxon qysh ka qenë?

Ismail Gashi: Te Verrat e Llukës ka qenë masë e madhe. E di që osht marrë p'i nivelit qëndror.

Erëmirë Krasniqi: A keni qenë?

Ismail Gashi: Po, kom qenë. Osht' ni... tradicionalisht aty ka pasë ni tubim pajtimesh edhe n'kohën e Haxhi Zekës, e ma herët. Aty o majt me ni, me ni qëllim poashtu t'vazhdimi të traditës. Kanë ardhë prej të gjitha viseve të Kosovës. Aty jonë falë, une qysh e dim mbi 60 gjaqe aty për aty i kanë çu dorë mas dorë letrën qi, "E fali une gjakun e djalit, e vllavit, e babës." Une e di qi ata kanë shkue, kanë shkue aty për aty domethanë. Pos disa dhjetë gjaqe që janë kanë t'lajmrume që kanë m'u pajtu. Aty ka qenë ni, si me thanë ni manifestim tepër i madh, shumë pozitiv, historik për shqiptarët. Edhe pse n'rrethana çfarë ish.

Erëmirë Krasniqi: Qysh ke ajo ditë?

Ismail Gashi: Nuk ka intervenu policia. Kom ni që rreth rrugës tani ka jemi kthy viseve t'ndryshme ka nalë njerz policia. Ka tentu me përdorë, me dëshmu si na jemi ktu, me dëshmu si mund t'përdorim dhunë e qesi sene. Ata dhunën s'e kanë ndërpre, s'e kanë ndërpre, po aty mrena tubimit që ish tubim tëpër i madh m'u provoku e me dheta milic ajo punë nuk ish send qi nalet ai, ai ish ni, ni vullkan i madh.

Erëmirë Krasniqi: E ju keni qenë aktivist i LDK-së në atë kohë? Në atë kohë LDK-ja ka qenë hala e re a po?

Ismail Gashi: LDK-ja ka qenë e vetmja parti...

Erëmirë Krasniqi: Ishit aty si anëtar i LDK-së, a qysh?

Ismail Gashi: Ah?

Erëmirë Krasniqi: Kur ndihmojshnit n'pajtime, a shkojshnit si aktivist apo si anëtar?

Ismail Gashi: Ja, ja, ja në pajtime na kena shkue normalisht. E kena përmen kanihere edhe partinë, se osht' proces politik ai, se ish pozitive ajo punë. Se na nuk kena shku si partiak. Kena shku si shqiptarë, si njerëz të barabartë. Edhe pse ato tri-katër parti tjera që i kishim, ishin shumë minore, krahas Lidhjes Demokratike ishin t'vogla, po ekzistonin domethanë. Se edhe Kshilli i të Drejtave ka lujt at rolin e vet, se ai u formu dikun ma herët se Lidhja Demokratike, me 14 nëntor m'doket, '98-ën, e Lidhja Demokratike 23 dhjetor osht'...

Erëmirë Krasniqi: '88-ën?

Ismail Gashi: '98, jo '89, '89, '89, se i ngatrrua vitet. Po kanë pasë funksionin vet, ato poplli e gzonte atë lëvizje, atë atë ngjallje, atë ngjallje. Pamvarsisht dhunës, ajo ngjallje ish edhe fuqia e rezistencës domethanë, fuqi rezistence. Ni energji që shihej po mendonte dikush se ai osht' i robnum ky popull, i robnum po, po kish energji për rezistencë, kish energji. Edhe ajo u dëshmu domethanë. Nuk shkum rastsisht p'i sistemit shkollor, na e ndamë, e ndajtëm në '90-tat, e dajtëm p'i Serbisë edhe e bamë t'pavarun nëpër shtëpi, shkolla, se po mos ta bënim ate, do t'kishim mbetë na pesë, nëntë vite mrapa. Do t'i kish ra, ta zamë, ni fmijës shtatë vjeçar me ni tjetër 15 vjeçar ni klasë. Për tetë vjet do ta kishim shkputë zinxhirin e vazhdimsisë së sistemit shkollor.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e organizutë edukimin... përmes LDK-së apo përmes aktivizmit lokal apo?

Ismail Gashi: Shiko, na dikur kena pasë nisë m'i ba do subjekte qeveritare se edhe atëherë e kena pasë shpallë ni Republikë, edhe ajo Republika nuk na u njoft përjashtë, por na e njifnim përmrena, se na e njihnim qenien tonë e kishim atë Republikë se i bamë institucionet e shtetit. Kenë Këshilli i Financimit, për shemull, që e kena qujt atëherë, Këshilli i Arsimit, nuk kanë qenë subjekte partiake. Ato jonë formu nga LDK-ja se i ka pasë 90 përqind, përmes LDK-së jonë formu. Por, masi ish Ministria jashtë, ne kishim vendimin, une e kom marrë për shembull, kryetar i Arsimit, e kom marrë p'i Bicajt, e ka nënshkru Ministri i Arsimit të Republikës të Kosovës. Në '95 jom emnu, me 1 gusht, kryetar i Këshillit të Arsimit. Atë vendim e kom marrë mas tre dite. Domethanë, qeveria ka ekzistu, jo partiake, por ajo qeveri që osht' formu p'i partive. Na kena pasë ni kuvend. Kena pasë në kuvend të gjitha partitë, kanë pasë kapak deputetë, sipas madhsisë që kanë qenë. Mirret vesh LDK-ja ka pasë dikun 80 përqind të veneve, se kemi qenë ma, ma e madhe, ma e shtrime. Se unë mas luftës s'jom marr mo me asni parti, po as me LDK jo. Kom qenë n'Këshill të Përgjithshëm atje në LDK, n'mandatin e fundit, qato që gati u prishëm, edhe me, jom largu edhe pi partisë.

Erëmirë Krasniqi: Qysh e kalut luftën? Qysh ke lufta?

Ismail Gashi: Në luftë kom nejt une, ktu m'ka zanë bombardimi, jo në qet' banesë, dikun tjetër. E qetu jom dalë qe tri vjet. Me shoqen jom ktu edhe me qat' vajzën e martume në Tiranë, ma shpesh rrin ktu. Sebeq [per shkak] punës kom nejt në Lipjan natën e parë, dytën kom shku në fshat, në Sllovi. Kom nejt

deri me 15 prill [1999], 15 prill na ka sulmu në Sllovi, i kanë vra 45 shqiptarë aty, fshati që ka psu ma së shumti. Kom dalë n'mal, prej malit jom kthy në Smallushë t'nesrit. Kom nejt deri 27 prill, 27 prill Ferizaj deri me 20 maj jom dalë n'Maqedoni. Prej 20 maj, kom nejt nja ni muj, jo t'plotë n'Gostivar. Jom kthy tani mas luftës.

Erëmirë Krasniqi: A keni humbë najkon gjatë luftës?

Ismail Gashi: Jo, kushëri po, t'afërt, farefis ma t'largtë pak, se t'shpisë teme jo. Se tashi, jonë vra shumë n'katun tem. 45 jonë t'vram aty.

Erëmirë Krasniqi: Prej vendasve a paramilitarëve [serb]?

Ismail Gashi: Vendas ka, edhe serb vendas ka pasë, ka edhe paramilitarë. Ka vra kush ka mujt aty. U sulmu fshati n'ora 1:30, p'i dy drejtimeve kanë gju kush ka mujt aty. Bile, bile, karshi asaj une kom dalë i pari për me ik, i pari kom ik (qeshë). Kom dalë me ni kodër osht' mbi fshat aty, e kom pa at' farë përzimje e madhe që s'dihej çka ndodhë aty, kur e kena llogaritë n'fund 45 kom thanë, "Prapë pak, kena pshtu lehtë." Se u kanë i sulmum shumë keq. Tana kena pasë 72 shpi serbe mrena, që kanë majt njerz aty.

Erëmirë Krasniqi: A jonë veshë ata?

Ismail Gashi: Jonë veshë valla nja 26 çka i kom une, a 26-7 qeshtu, kanë qenë t'veshun. Të mobilizum si rezerva policisë, si rezerva t'ushtrisë veç me uniforma.

Erëmirë Krasniqi: Kur u kthytë? Manej si refugjatë prej Gostivarit?

Ismail Gashi: Prej Gostivarit jemi kthy n'fshat maspari nja ni javë ditë, se e kom pa lanë babën t'paralizum une. E kom pasë babën t'paralizum kur jom shkue, se qeky vllai madh e ka majt tani qato ditë, se baba me mu ka jetu 25 vjet. Edhe e kisha dertin që po vdes pa e pa edhe une, po m'shkon ai muni huq që thojnë. E kom gjetë gjallë po, po krye t'javës ka vdekë. Kom ardhë n'banesë tana mas ni jave. Kena organizu tani punë tjera, ngushllimet nëpër territor t'komunës, e n'Sllovi teme, kena pasë atë t'pamën e përbashktë t'shkollës, se i kishim 37-8 familje që i kishin prekë me vrasje. Nuk mundte ni njeri me ardhë m'i pa 37-8 familje për dy ditë. E bamë n'shkollë, i thirrëm ata familjarët. Ktu për çdo shpi vijnë ka njo, ka dy rrini, n'ardhshin tana për shtatë ditë, edhe p'i Peje na kanë ardhë autobusa, që kanë ni. E patëm shpallë ato njoftime që janë vra 45, e pamja asht' kshtu e kshtu.

Erëmirë Krasniqi: E qysh u aktivizut mandej mas luftës ju?

Ismail Gashi: Mas lufte une s'jom aktivizu. Kom punu n'komunë si këshilltar m'kanë thanë për shkolla t'mesme, realisht s'kom ba punë shumë efektive ma se hinën reformat, e kto format e kta t'jashtmit me na majt do derse e do msime do, "Jo mahet shkolla kshtu, jo s'mahet kshtu". Une nuk jom kundër përsosjes, por shkolla shqipe e ka ni traditë. Ka ni traditë, nuk e kena lanë pa reformu edhe qato dhjetë vjet e okupimit. Na e kena hekë sistemin ideologjik n'msime, e kemi hekë komunizmin, e kemi hjek

vllaznim-bashkimin, e kemi shti Informatikën si landë gjatë bash n'qatë okupimin kur ishim nën okupim.

E kemi shti edukatën qytetare bash n'edukim, e kemi shti si n'qatë dhjetë vjeshin e okupimit, se une i kom udhëheqë vet ato, pe di edhe n'nivel Kosove qysh jemi marrë vesh, bile edhe me Shqiprinë. Ose edhe pesë landë që janë materiet kombëtare, gjuha, historia, gjeografia, arti muzikor, arti figurativ, i kena shti ato materiet shqiptare që s'i ka pasë n'kohën e komunizmit. E kena materializu kombtarisht programin msimor, edhe nuk ish kjo pak, po atëherë rrethanat që në Lipjan mu m'kanë msu 1000 fmijë me ni shpi private, katra me katra janë ulë, ni dhomë janë ulun 38 fmijë. Që une kur u konë qekjo për të drejta të njeriut prej Beogradit, p'ia harroj emrin ksaj...

Erëmirë Krasniqi: Natasha Kandiç?

Ismail Gashi: Po Kandiçi, kur ka ardhë nihere, se ka ardhë disa herë n'Lipjan...

Erëmirë Krasniqi: Gjatë '90-tave?

Ismail Gashi: Ka ardhun, "A bon me hi n'shkollë private?" "Po, more". Kur ka hi. Mu m'ka thonë ajo vet qetu n'shkollë private, "Po mos t'punoja unë qet' detyrë që e kom n'sistemin e Millosheviqit, s'kisha pranu me punu kurrë, a kisha punu taksiste". A n'sistem të Millosheviqit, qysh si vje turp fëmija, 40 fëmijë mu djersitë aty me ni ambient shumë t'ngushtë, pa drrasë t'zezë ose me do fosne që i thojshim do drrasa t'trasha... mu ulë, mu ulën. S'kem pasë mobilje do me... s'kem pasë inventarë na aty.

Jo ministria... tash s'ka kuptim me folë, jom pak i... me qenë shumë objektiv, nuk, nuk dalim, qysh po flasim, ma pak dalim, edhe n'aspektin e qeverisë. Na ka shku n'egzil kta njerz nuk e di çka kanë bo. Ma shumë punt e arsimit p'i di se aty jom konë i lidhun. Na i kena pasë nja tre persona ktu që e krynin punën e ministrit, Abdyl Rama, Xhavit Ahmeti edhe Rexhep Osmani. Kta na ftonin neve kryetarët e arsimit që ishim t'komunave, çdo dy javë ose ma shpesh ose ma rrallë qysh donin ata, e na bisedonim me ata aty, çka me bo me ktë, p'i zgjedhim drejtorat, p'i shpallum konkursin për arsimtar, p'i bajmë ktë, domethanë e qeverisnim n'bashkëpunim me kta tre.

Une ministrin e kom pa në Tiranë nihere kur kom shku. Kom shku për punë tjera, s'kom shku për, ktu e kom pa edhe ministrin në Tiranë, Bicaj. Se ai ka qenë jashtë domethanë, kta nashta kanë çue programe a najsen ktyne, po une nuk besoj se kta krejt që i kena marrë me Shqiprinë bashkëpunimet, ma çelt kena qenë atëherë. Bile qitashi përveç qesaj abetare që e bonën edhe harrun bile edhe ata s'pe dinë a pe zbatojnë, a s'pe zbatojnë ma. Se ni abetare unike e bonëm për kombin shqiptar, po e shkepëm ata atje edhe ktu po kërkush s'e kontrolloi ma a po zbatohet vërtetë. Une p'e di që në Shqipëri përdoren prapë nja dy- tri ma së paku. Edhe le ma tjerat që s'i bonëm. Na e kena pasë para lufte ketë program, m'i ba tekstet unike kombëtare, edhe me ba kalendarin shkollor kombëtar. Bile, edhe fillimin e vitit shkollor mos me qenë me të parin edhe të 15 shtator, po me ba me të parin, ose 15. Me qenë për te dyja shtetet, për gjithë shqiptarët domethanë. Edhe tashi po hi thellë, s'pe ngucim ketë muhabet.

Erëmirë Krasniqi: Domethanë, komunikimi ka qenë shumë ma i mirë atëhere se sa mas luftës?

Ismail Gashi: Qetash, qetash jem t'libër që po shkojmë n'Shqipni, une shkoj...

Erëmirë Krasniqi: Po menoj në nivel institucional.

Ismail Gashi: Tash edhe miq, edhe une t'shtunen, t'dillen shkoj. Edhe kanihere sa ke vera veç shkojmë n'bregdet veç vikendeve, vjen edhe djali me nuse, edhe une me plaken teme, s'guxoj, nuse i thom edhe une, po për ju p'e thomë plakë (buzëqeshë). Se edhe, na shkojmë tash ajo osht' e lirë me shku tashi e lirë, liria jonë me shku e po shkojmë shpejt se osht' autoudha. Megjithatë, këtë afrimin, integrimin mrena kombit mu s'po m'doket që jemi mirë, s'po m'doket që jemi mirë. Na mujmë shumë ma shumë. Osht' dashtë me ba n'shkolla tekstet unike, osht' dashtë m'i bo krejt ato planprograme, kurrikula që p'i thojnë tash, jo na me marrë kurrikulë rumune, me përkthi në shqip edhe me materializu shqip edhe mos me marrë të tyne. Të tyne ose mu ulë bashkarisht me ba bashkarisht, na kena eksperta t'saj.

Erëmirë Krasniqi: Ju përmendet që keni qenë pjesë e ksaj Lëvizje Nacional-Çlirimtare, ata kanë qenë për bashkim edhe i kanë pasë do ide me Shqipninë, qysh i braktisët ato ide?

Ismail Gashi: Baci Metush, baci Metush o kanë dallim, une besoj që, une e kom atë bindje, nashta s'osht ashtu, po une e di që koxha shumë osht', nuk o konë Enverist ai. Ai edhe na ka thanë kanihere, "Qy, me sha mos e shani se s'ka kuptim, po mos dilni në Evropë m'i thanë dikuj, naj gjermani, naj francezi, Marksizëm-Leninizëm, ai t'vetin e ka Marksini nuk e qet' kun". Du me thanë dallimi u kanë në Bacin Adem. Baci Metush u kanë krejt tjetër. Ma vigan, ma vigan u kanë, ma i madh. Ai ka lypë me punue, ka lypë me punue, edhe ka pasë mençuri t'punës vet, po tashi rrezikshmëria u kanë patjetër e madhe. Nuk jena tërhjek na prej asaj, une n'koncept temin e kom që kjo rrugë nuk mund t'ndalet, po n'rrethana t'ardhshme dikush po thotë mos e përmeni se bashkohmi në Evropë. Na nuk o mirë m'u bashku në Evropë, po kur jemi ktu t'bashkum... na e kem nifarë vije t'kufinit, po ajo osht' krejt formale edhe ni gjuhë e kemi, ni histori e kemi, ni traditë e kemi, ni abetare duhet ta kemi, ni flamur duhet ta kemi.

Erëmirë Krasniqi: Kur jeni pensionu?

Ismail Gashi: He?

Erëmirë Krasniqi: Kur keni dalë n'pension?

Ismail Gashi: Me 10, me 14 qershor të 10, të 2010-ës.

Erëmirë Krasniqi: E çka boni tash? Qysh e organizoni kohën?

Ismail Gashi: Tash rri, rri ma shumë. Mirrna kapak, shkarraviti kanihere kapak diçka. Po s'kom punu mirë, s'kom ditë me shkru kur jom kanë i ri (buzëqeshë). Qetash p'i nejtës të tepërt po duhet me hargjitë kohë kishe po shkruj dishka.

Erëmirë Krasniqi: A keni diçka me shtu?

Ismail Gashi: Ju falenderoj shumë, ju falenderoj shumë. Nëse kom thonë dishka, nalne për t'mirë, nëse s'kom thanë lene.